



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 723, datë 07.12.2023**

**PËR**

**MBYLLJEN E PROCEDIMIT DISIPLINOR TË FILLUAR NDAJ MAGJISTRATIT {...}, ME FUNKSION GJYQTAR PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DURRËS**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, më datë 07.12.2023, pasi u njoh me materialet e procedimit disiplinor, të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës,

**V Ë R E N:**

**I. TË DHËNA MBI FILLIMIN E PROCEDIMIT DISIPLINOR**

1. Magjistrati {...}, aktualisht ushtron detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
2. Ministri i Drejtësisë, me shkresat nr. 4281/3 prot., datë 01.10.2012 dhe nr. 6127/17, datë 26.10.2012, ka paraqitur kërkesat para ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për nisjen e procedimit disiplinor të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, z. {...} duke propozuar vendosjen e masës disiplinore “*Shkarkim nga detyra*”.
3. Pas paraqitjes së kërkesave për nisjen e procedimit disiplinor, Ministri i Drejtësisë me kërkesën nr. 486 prot., datë 23.01.2013, si dhe me kërkesën nr. 486/1 prot, datë 10.07.2013, ka kërkuar pezullimin e kërkesave për procedim disiplinor ndaj magjistratit {...}
4. Në vijim, ish Këshilli i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 304, datë 14.02.2013, ka vendosur pezullimin e shqyrtimit të kërkesës së Ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor ndaj gjyqtarit {...} deri në përfundimin e shqyrtimit të çështjes në gjykatat më të larta. Gjithashtu me vendimin nr. 354, datë 19.07.2013 ish KLD ka vendosur të miratojë kërkesën e Ministrit të Drejtësisë për vazhdimin e pezullimit të shqyrtimit të kërkesave për procedim disiplinor ndaj gjyqtarit {...}.

5. Me shkresën nr. 3696/1 prot., datë 30.06.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor i ka dërguar për kompetencë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, praktikën lidhur me kërkesën e Ministrit të Drejtësisë për pezullimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit {...}.

6. Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr. 2170/1 prot., datë 28.07.2023, protokolluar në Këshill me nr. 3696/2 prot., datë 31.07.2023, pasi ka analizuar aktet e dërguara, ka vlerësuar se nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor duhet të zhvillohet një proces mbi verifikimin e rënies apo ekzistencës së shkakut të pezullimit, si dhe duhet të merret një vendim i ndërmjetëm lidhur me rifillimin ose jo të procedimit disiplinor. Sipas Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pas vendimmarrjes së datës 19.07.2013 nga ish Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk është zhvilluar asnjë procedurë apo marrë asnjë vendim në lidhje me kërkesat për nisje procedimi disiplinor ndaj magjistratit {...}.

7. Nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor u verifikua nëse aktualisht ekzistonin ende shkaqet, bazuar në të cilat ishte pezulluar procedimi disiplinor ndaj magjistratit {...}.

7.1 Nga verifikimet e bëra, rezultoi se çështja për shkak të së cilës ishte vendosur pezullimi i shqyrtimit të kërkesave për procedim disiplinor ndaj magjistratit {...}, ka përfunduar së shqyrtuari në të gjitha shkallët e gjykimit dhe nuk ka pengesa ligjore për të vijuar me shqyrtimin e procedimit disiplinor.

8. Në kushtet kur tashmë shkak i pezullimit të shqyrtimit të kërkesave për procedim disiplinor, konsideruar nga ish Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në vendimet e tij nr. 304 datë 14.02.2013 dhe nr. 354 datë 19.07.2013, ka rënë dhe nuk ekziston më, nga Këshilli u vlerësua se janë kushtet e shfuqizimit të vendimeve të pezullimit. Gjithashtu, me rënien e shkakut të pezullimit dhe shfuqizimin e vendimeve përkatëse rezulton se tashmë nuk ekziston asnjë shkak që të pengojë shqyrtimin e kërkesave për procedim disiplinor.

8.1 Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 702 datë 30.11.2023 vendosi: “1. *Shfuqizimin e vendimeve nr. 304 datë 14.02.2013 dhe nr. 354 datë 19.07.2013 të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për pezullimin e e procedimit disiplinor deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në gjykatat më të larta”.* 2. *Vijimin e shqyrtimit të kërkesës për procedimin disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe dërgimin e akteve Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.*

## **II. PROCEDURA E ZHVILLUAR NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

9. Me vendimin nr. 717, datë 06.12.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është vendosur caktimi me short i relatorit të çështjes si dhe caktimi i datës 07.12.2023 si datë e zhvillimit të seancës dëgjimore, për shqyrtimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

10. Vendimi për caktimin me short të relatorit të çështjes dhe për caktimin e datës së seancës dëgjimore i është njoftuar rregullisht palëve në zbatim të parashikimeve të nenit 138 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. (në vijim Ligji për Statusin)

10.1 Gjithashtu, së bashku me njoftimin për caktimin e seancës dëgjimore, magjistratit i janë njoftuar dhe të drejtat e tij gjatë procedimit disiplinor, referuar nenit 141, pika 2 e Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 32 pika 1 të Rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, e miratuar me vendimin nr. 316, datë 14.09.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

### III. RRETHANAT E FAKTIT

11. Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë bazuar në Urdhrin nr. 4281/2, datë 17.07.2012 të Ministrit të Drejtësisë “Për ushtrim inspektimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës” në datën 18.07.2012 ka ushtruar inspektim pranë kësaj gjykate për verifikimin e ankesës së subjektit “Raiffeisen Bank” sh.a. Objekt i inspektimit ka qenë verifikimi i ligjshmërisë së veprimeve procedurale gjyqësore gjatë gjykimit të çështjes civile me palë paditëse “Shoqëria “Kërçuku” sh.p.k; palë e paditur: “Raiffeisen Bank” Sh. a dhe Shoqëria “Petani Bailiff Office” sh.p.k; objekt: *“Kundërshtim i veprimeve përmbareme, të paditur shoqëria private përmbareme “Petani Bailiff Office” për procedurat abuzive të ankandit si dhe pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, urdhrin të ekzekutimit nr. 322, datë 28.05.2010; nr. 323, datë 01.06.2010; nr. 778, datë 15.09.2010; nr. 777, datë 10.09.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe nr. 4160, datë 29.12.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi detyrimi nuk është në vlerën e pretenduar.”*

11.1 Kjo padi është depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe i është caktuar me short gjyqtarit {...}, i cili pasi ka dëgjuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse, ka vendosur *“pranimin e kërkesës së paditësave shoqëria “Kërçuku” shpk. dhe pezullimin e veprimeve përmbareme për ekzekutimin e titujve ekzekutivë deri në përfundim të gjykimit të çështjes”*

11.2 Përveç seancës (përgatitore) për sigurimin e padisë, e deri në datën e inspektimit 18.07.2012, janë zhvilluar gjithsej edhe 5 seanca të tjera gjyqësore. Ndërkohë nga verifikimi administrativ pas inspektimit ka rezultuar se në datë 03.09.2012 gjyqtari Markeljan {...} ka paraqitur tek Kryetari i Gjykatës kërkesë për dorëheqje nga gjykimi i çështjes së themelit me arsyetimin se *“nisur nga shkeljet procedurale që jam vënë në dijeni në raportin e inspektimit dhe pse nuk jam dakord, çmoj të mos vazhdoj më tej gjykimin e kësaj çështje pasi vlerësoj se çdo vendimarrje e imja do të paragjykohet”* Kërkesa për heqje dorë është miratuar nga Kryetari i Gjykatës në datë 03.09.2012, dhe çështja është rishortuar.

11.3 Ministria e Drejtësisë, pasi ka analizuar dosjen gjyqësore objekt inspektimi, ka nxjerrë përfundimet e mëposhtme:

- i. janë shkelur rëndë dispozitat procedurale për pezullimin e ekzekutimit të titujve, me pasojë dëmtimin e interesave të ligjshme të palëve në proces.
- ii. nuk ka një adminsitrim të mirë të kohës lidhur me aktin e ekspertimit
- iii. në rastin objekt inspektimi, gjyqtari i çështjes sa i përket kundërshtimit të veprimeve përmbaremore, ka shkelur haptazi afatin ligjor sepse çështja vazhdon të gjykohet për më shumë se 1 muaj e gjysmë.

11.4 Në përfundim, Ministria e Drejtësisë me pretendimin se nga ana e gjyqtarit {...} janë shkelur rëndë dispozitat procedurale për pezullimin e ekzekutimit të titujve, me pasojë dëmtimin e interesave të ligjshme të palëve në proces, me shkresën nr. 4281/3 prot., datë 01.10.2012 ka kërkuar nisjen e procedimit disiplinor të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, z. {...} duke i propozuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë, vendosjen e masës disiplinore “*Shkarkim nga detyra*”.

12. Referuar kërkesës për procedim disiplinor ndaj magjistratit {...}, me shkresën nr. 6127/17 prot., datë 26.10.2012, drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është parashtruar se Këshilli i Lartë i Drejtësisë në datë 24.009.2009 ka urdhëruar verifikimin e informacionit të paraqitur nga ana e Kryetarit të ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, sot Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës në lidhje me veprimtarinë gjyqësore të magjistratit {...}. Këshilli i lartë i Drejtësisë me shkresën 1478 prot., datë 27.09.2012, ka njoftuar Ministrin e Drejtësisë mbi rezultatet e inspektimit të ushtruar, me qëllim mundësinë e fillimit të procedimit disiplinor.

12.1 Bazuar në relacionin e përgatitur nga ana e Inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është arritur në përfundimin se magjistrati {...} me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, gjatë periudhës objekt verifikimi nuk ka patur mungesa pa arsye në detyrë, por vetëm 17 vendime gjyqësore të dorëzuara jashtë afati.

12.2 Në analizë të fakteve të parashtruara, Ministria e Drejtësisë ka çmuar se magjistrati {...} duhet t’i nënshtrohet përgjegjësisë disiplinore në përputhje me nenet 31 e vijues të ligjit nr.9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, për kryerjen e akteve e të sjelljeve të cilat diskretitojnë pozitën dhe figurën e tij në përputhje me parashikimet e nenit 32 të këtij ligji.

12.3 Me shkresën nr. 6127/17 prot., datë 26.10.2012, Ministri i Drejtësisë bën me dije se në konkluzion të inspektimit të ushtruar në bazë të Urdhrit nr.58, datë 08.02.2012 të Ministrisë të Drejtësisë “*Për ushtrim inspektimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat*” me objekt verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve procedurale në çështjet gjyqësore me objekt kundërshtimin e veprimeve përmbaremore, sigurim padie, me shkresën nr. 58/2 prot., datë 01.10.2012, bazuar në nenin 147/6 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka kërkuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë,

nisjen e procedimit disiplinor për magistratin {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke propozuar bashkimin e këtij procedimi, me kërkesën për procedimin disiplinor të dërguar me shkresën nr. 4281/3 prot., datë 01.10.2012 dhe caktimin e masës disiplinore “*shkarkim nga detyra*”.

13. Pas paraqitjes së kërkesave për nisjen e procedimit disiplinor, Ministri i Drejtësisë me kërkesën nr. 486 prot., datë 23.01.2013, si dhe me kërkesën nr. 486/1 prot, datë 10.07.2013, ka kërkuar pezullimin e kërkesave për procedim disiplinor ndaj magistratit {...}.

13.1 Në vijim, Këshilli i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 304, datë 14.02.2013, ka vendosur pezullimin e shqyrtimit të kërkesës së Ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor ndaj gjyqtarit {...} deri në përfundimin e shqyrtimit të çështjes në gjykatat më të larta.

13.2 Gjithashtu, me vendimin nr. 354, datë 19.07.2013, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vendosur të miratojë kërkesën e Ministrit të Drejtësisë për vazhdimin e pezullimit të shqyrtimit të kërkesave për procedim disiplinor ndaj gjyqtarit {...}.

14. Me shkresën nr.3696/1 prot., datë 30.06.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor i ka dërguar për kompetencë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, praktikën lidhur me kërkesën e Ministrit të Drejtësisë për pezullimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit {...}.

14.1 Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr.2170/1 prot., datë 28.07.2023, protokolluar në Këshill me nr. 3696/2 prot., datë 31.07.2023, pasi ka analizuar aktet e dërguara, ka vlerësuar se nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor duhet të zhvillohet nje proces mbi verifikimin e rënies apo ekzistencës së shkakut të pezullimit, si dhe duhet të merret një vendim i ndërmjetëm lidhur me rifillimin ose jo të procedimit disiplinor.

14.1.1 Sa më sipër, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor u verifikua nëse aktualisht ekzistonin ende shkaqet, bazuar në të cilat ishte pezulluar procedimi disiplinor ndaj magistratit {...}, dhe konkretisht me anë të postës elektronike në datë 22.11.2023 u kërkuar informacion nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, mbi ecurinë e çështjes civile nr.21274-04093 (2276) datë 25.05.2012, në të gjitha shkallët e gjyqimit, që u përket palëve paditës shoqëria “Kërçuku” shpk etj, me objekt kundërshtimi i veprimeve përmbarimore, gjykuar nga gjyqtari {...}.

15. Nga informacioni i ardhur nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës me anë të postës elektronike në datë 23.11.2023, si edhe me shkresën nr.6359 prot., datë 23.11.2023, protokolluar në Këshill me nr.3696/3 prot., datë 30.11.2023, rezulton se:

15.1.1 Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari {...}, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën e Shoqërisë tregtare

“Kërçuku” sh.p. k etj. me objekt sigurimin e padisë dhe pezullimin e veprimeve përmbare, me vendimin e ndërmjetëm datë 25.05.2012 ka vendosur:

- *Pranimin e kërkesës së paditësive Shoqëria Tregtare Kërçuku sh.p.k. me qendër në Durrës dhe Ramazan Kërçuku.*
- *Pezullimin e ekzekutimit të veprimeve përmbare për ekzekutimin e titujve ekzekutiv urdhrin e ekzekutimit nr. 322 datë 28.05.2010, nr. 323 datë 01.06.2010, nr. 778 datë 15.09.2010, nr. 777 datë 10.09.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, nr. 4160 datë 29.12.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, deri në përfundim të gjyqimit të çështjes.*
- *Kundër vendimit mund të bëhet ankim i veçantë brenda 5 ditëve nga e nesërmja e shpalljes në Gjykatën e Apelit Durrës.”*

15.1.2 Ndaj vendimit të mësipërm, është ushtruar e drejta e ankimit dhe Gjykata e Apelit Durrës, pasi ka shqyrtuar çështjen me vendimin nr. 1570 (136) datë 30.10.2012 ka vendosur: “- *Ndryshimin e vendimit datë 22.05.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës si më poshtë:*

- *Rrëzimin e kërkesës së paditësit Shoqëria Tregtare Kërçuku sh.p.k. dhe Ramazan Kërçuku për marrjen e masës së përkohshme të sigurimit të padisë për pezullimin e ekzekutimit të veprimeve përmbare për ekzekutimin e titujve ekzekutiv urdhrin e ekzekutimit nr. 322 datë 28.05.2010, nr. 323 datë 01.06.2010, nr. 778 datë 15.09.2010, nr. 777 datë 10.09.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, nr. 4160 datë 29.12.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.”*

15.1.3 Nga palët ndërgjyqëse është ushtruar e drejta e rekursit në Gjykatën e Lartë, duke kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Apelit, si dhe duke kërkuar pezullimin e këtij vendimi. Gjykata e Lartë pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1570 (136) datë 30.10.2012 të Gjykatës së Apelit Durrës, me vendimin e saj nr. 481 datë 09.11.2012 ka vendosur:

“*Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 10-2012-1570 datë 30.10.2012 të Gjykatës së Apelit Durrës”.*

15.1.4 Gjykata e Lartë pasi ka marrë në shqyrtim rekursin e ushtruar ndaj vendimit nr. 1570 (136) datë 30.10.2012 të Gjykatës së Apelit Durrës, në dhomë këshillimi, me vendimin e saj nr. 406 datë 19.02.2016 ka vendosur:

“*Mospranimin e rekursit të paraqitur nga paditësat Shoqëria Tregtare Kërçuku sh.p.k. dhe Ramazan Kërçuku, kundër vendimit nr. 1570 (136) datë 30.10.2012 të Gjykatës së Apelit Durrës”.*

15.1.5 Ndërkohë, shqyrtimi i padisë në themel ka përfunduar nga një trup tjetër gjyqësor, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-2012-9244) 3423 datë 28.12.2012, duke u vendosur pranimi pjesërisht i kërkesë padisë. Ky vendim ka marrë formë të prerë pa u ankimuar.

16. Nga verifikimet e bëra sa më sipër, rezultoi se çështja për shkak të së cilës ishte vendosur pezullimi i shqyrtimit të kërkesave për procedim disiplinor ndaj magjistratit {...}, ka përfunduar së shqyrtuari në të gjitha shkallët e gjyqimit dhe nuk ka pengesa ligjore për të vijuar me shqyrtimin e procedimit disiplinor.

17. Në kushtet kur tashmë shkak i pezullimit të shqyrtimit të kërkesave për procedim disiplinor, konsideruar nga ish Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në vendimet e tij nr. 304 datë 14.02.2013 dhe nr. 354 datë 19.07.2013, ka rënë dhe nuk ekziston më, nga Këshilli u vlerësua se janë kushtet e shfuqizimit të vendimeve të pezullimit. Gjithashtu, me rënien e shkakut të pezullimit dhe shfuqizimin e vendimeve përkatëse rezulton se tashmë nuk ekziston asnjë shkak që të pengojë shqyrtimin e kërkesave për procedim disiplinor.

18. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 702 datë 30.11.2023 vendosi: “1. *Shfuqizimin e vendimeve nr. 304 datë 14.02.2013 dhe nr. 354 datë 19.07.2013 të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për pezullimin e e procedimit disiplinor deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në gjykatat më të larta”.* 2. *Vijimin e shqyrtimit të kërkesës për procedimin disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe dërgimin e akteve Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.* Ky vendim iu komunikua magjistratit z. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

19. Me vendimin nr. 717, datë 06.12.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: “1. *Caktimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor z. Ilir Rusi, në cilësinë e relatorit për procedimin disiplinor, të filluar ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.* 2. *Caktimin e datës 07.12.2023, ora 11:00, si datë e zhvillimit të seancës dëgjimore për shqyrtimin e e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”.*

#### **IV. PARASHTRIMET E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË**

20. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka paraqitur pretendimet e tij të argumentuara në parashtrësën nr. 2170/5 prot., datë 07.12.2023, të depozituara në Këshill dhe protokolluar me nr. 3695/2 prot., datë 07.12.2023. Ato janë parashtruar në vijimësi si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore të datës 07.12.2023.

21. Në pretendimet e tij, Inspektori i Lartë i Drejtësisë referon se nga praktika dokumentare lidhur me kërkesën për procedim disiplinor nga ana e Ministrit të Drejtësisë, në lidhje me magjistratin {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, rezulton se shkeljet e pretenduara kanë ndodhur në vitin 2009 dhe 2012.

22. Në kohën kur kanë ndodhur shkeljet e pretenduara, për shkeljet disiplinore të kryera nga magjistratët ka qenë në fuqi Ligji nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit

gjqësor në Republikën e Shqipërisë”, i cili në nenin 34, pika 2, parashikonte se: “*Fillimi i procedimit disiplinor mund të bëhet jo më vonë se 1 vit nga data e konstatimit të shkeljes nga organi që ka të drejtën për fillimin e këtij procedimi, por jo më vonë se 5 vjet nga data e kryerjes së shkeljes*”

23. Për sa më sipër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerëson se shkeljet e pretenduara për të cilat ka nisur procedimi disiplinor ndaj magistratit {...} janë parashkruar.

24. Në përfundim, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kërkuar mbylljen e procedimit disiplinor të filluar ndaj magistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për shkak të parashkrimit të shkeljeve disiplinore, për të cilat ka nisur ky procedim.

## **V. PARASHTRIMET E MAGJISTRATIT, Z. {...}**

25. Në seancën dëgjimore të datës 07.12.2023, magistrati, z. {...}, paraqiti parashtrimet e tij në mënyrë verbale, lidhur me kërkesën e Ministrit të Drejtësisë për nisjen e procedimit disiplinor dhe parashtrësës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për mbylljen e procedimit disiplinor.

26. Në lidhje me shkeljet e pretenduara të cilat më pas kanë sjellë nisjen e procedimit disiplinor, magistrati shprehu qëndrimin e tij, duke deklaruar se ky procedim ishte i padrejtë dhe se nuk ka kryer asnjë shkelje ligjore për të cilën duhet të mbajë përgjegjësi.

27. Si përfundim, magistrati u shpreh se është dakord me kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për mbylljen e procedimit disiplinor të filluar ndaj tij.

## **VI. SITUATA LIGJORE**

### **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**

28. Në nenin 147, pika 1 parashikohet se: “*1. Këshilli i Lartë Gjyqësor siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë....*”, ndërsa neni 147/d përcakton se Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve, sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

29. Me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, të bëra me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, të cilat kanë hyrë në fuqi në datën 11.08.2016, në nenin 147/a dhe 147/d është parashikuar ngritja si organe kushtetuese e institucionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.



30. Në mbështetje të nenit 147/a, shkronja “b” të Kushtetutës, Këshilli i Lartë Gjyqësor është institucioni përgjegjës për të vendosur masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve. Ndërsa në mbështetje të nenit 147/d, pika 1, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është institucioni përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

### **Ligji për Statusin<sup>1</sup>**

### **Ligji për Qeverisjen<sup>2</sup>**

31. Në kuadër të zbatimit të ndryshimeve kushtetuese duke përfshirë miratimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës që do t'i shërbejë implementimit të plotë të dispozitave kushtetuese në këndvështrimin procedural dhe teknik nga ana e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë është miratuar ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, i cili ka hyrë në fuqi në datën 16.12.2016 dhe Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, i cili ka hyrë në fuqi në datën 22.11.2016.

32. Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, ka për objekt përcaktimin e parimeve dhe rregullave për organizimin dhe funksionimin ndër të tjera, të Institucionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

33. Ndërsa Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka përcaktuar se cilat veprime/mosveprime të magjistratëve përbëjnë shkelje disiplinore, procedurën në lidhje me hetimin dhe zhvillimin e procedimit disiplinor, si dhe masat disiplinore të cilat mund të jepen ndaj magjistratëve për shkak të kryerjes së shkeljeve disiplinore nga ana e tyre.

34. Ndërkohë, duke mbajtur në konsideratë faktin se para hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, kompetencat në lidhje me hetimin apo zhvillimin e procedimit disiplinor të magjistratëve ushtroheshin në mënyrë të ndarë nga ana e organeve të tjera si Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm dhe Ministri i Drejtësisë, me dispozitat me karakter kalimtar të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, dhe Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, është synuar të rregullohet periudha kalimtare për shkak të krijimit të institucionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si dhe përfundimi i ushtrimit të funksioneve

---

<sup>1</sup>Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, është botuar në Fletoren Zyrtare nr.208, datë 7 Nëntor 2016 dhe ka pësuar ndryshime në vijimësi.

<sup>2</sup> Ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” është botuar në Fletoren Zyrtare nr.231, datë 1 Dhjetor 2016 dhe ka pësuar ndryshime në vijimësi.

nga ana e organeve të mëparshëm si Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, apo Ministria e Drejtësisë.

35. Dhe konkretisht në nenin 279, pika 4, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të Drejtësisë” i ndryshuar, parashikohet se: “4. Në ditën e krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor të gjitha dosjet dhe dokumentacioni në administrim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë i kalon Këshillit të Lartë Gjyqësor nën përgjegjësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të Kryeinspektorit.”. Ndërsa në nenin 283, pika 9 dhe 11 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të Drejtësisë” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “Në ditën e krijimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë pushon së zhvilluari veprimtaria e inspektimit pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe përfundon mandati i Kryeinspektorit...[...]. Në ditën e krijimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të gjitha dosjet disiplinore në proces hetimi nga Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Prokuroria e Përgjithshme kalojnë nga Kryeinspektori, drejtoritë përgjegjëse pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme në përgjegjësinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Çdo ankesë, në kuptim të këtij ligji, për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve i drejtohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.”

36. Neni 160, pika 1, shkronja “c” e Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ka parashikuar se ndër kompetencat e Këshillit të Lartë të Drejtësisë në këtë periudhë kalimtare deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosja e masave disiplinore me propozim të Ministrit të Drejtësisë, bazuar në procedurën dhe kriteret që parashikohen në pjesën V, Kreu I, të këtij ligji.

37. Ndërsa në pikën 5 të këtij neni, parashikohet shprehimisht se: “Deri në krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Prokurori i Përgjithshëm heton shkeljet disiplinore nëpërmjet inspektorëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, bazuar në procedurën dhe kriteret e pjesës V, Kreut I dhe dispozitës kalimtare të këtij ligji”. Në vijim, në pikën 6, të nenit 174 parashikohet se: “Çdo akt nënligjor i miratuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji zbatohet për sa nuk bie në kundërshtim me këtë ligj”.

38. Sipas përcaktimeve të nenit 172 “Dispozita kalimtare për procedimet disiplinore”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar: “Hetimet disiplinore të papërfunduara në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji nga Ministria e Drejtësisë, Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe inspektorët në Zyrën e Prokurorisë së Përgjithshme përfundohen brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sipas dispozitave në fuqi para hyrjes në fuqi të këtij ligji...[...]. Procedimet disiplinore të papërfunduara në Këshillin e Lartë të Drejtësisë ose në Prokurorinë e Përgjithshme në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji kryhen brenda afatit 6-mujor pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Organet përgjegjëse, sipas nenit 160, të këtij ligji, zbatojnë rregullat procedurale të

*parashikuara në këtë ligj...[...].Për shkeljet disiplinore të parashikuara sipas këtij ligji, që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të tij, dhe që parashikoheshin si të tilla në kohën e kryerjes së tyre, do të zbatohen dispozitat e këtij ligji, me përjashtim të parashikimeve të pikave 1 dhe 2 të këtij neni...[...].Organet kompetente për procedimin disiplinor zbatojnë parimin e zbatimit të ligjit më të favorshëm për magjistratin që ka kryer shkeljen disiplinore.”*

39. Në analizë të këtyre dispozitave ligjore, konstatohet se fryma që përshkon dispozitat me karakter kalimtar është vazhdimësia institucionale dhe e ushtrimit të funksioneve nga organet e mëparshme të Institucioni i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Parimi i vazhdimësisë (*kontinuitetit*) ligjor dhe institucional, është thelbi mbi të cilin çdo organ kushtetues ose i krijuar me ligj ushtron pushtetin, në rastet kur legjislacioni i ri ndryshon funksionin dhe kompetencat e organit ekzistues.

40. Nga ana e dispozitave ligjore me karakter kalimtar janë trajtuar në mënyrë të hollësishme një sërë çështjesh të cilat kanë të bëjnë me: (i) kompetencat dhe mënyrën e ushtrimit të tyre nga ana e organeve kompetente gjatë periudhës kalimtare deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; (ii) momentin e krijimit të institucionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor apo Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; (iii) transferimin e dosjeve apo dokumentacionit që administrohej paraprakisht nga ana e Këshillit të Lartë të Drejtësisë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor; (iv) momentin e ndërprerjes së veprimtarisë së inspektimit pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme; (v) kalimin e dosjeve disiplinore në proces hetimi nga Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Lartë të Drejtësisë dhe Prokuroria në përgjegjësinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; (vi) organin, procedurën, afatin apo edhe ligjin, i cili do të aplikohet në lidhje me hetimet disiplinore apo procedimet disiplinore të papërfunduara në datën e hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

## **VII. VLERËSIMI I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

41. Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke mbajtur në konsideratë natyrën dhe llojin e shkeljeve që i janë atribuar magjistratit nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, çmon të evidentojë se në kohën e dhënies të vendimeve gjyqësore, për të cilin ka filluar procedimi disiplinor ndaj gjyqtarit {...}, kanë qenë në fuqi dispozitat e Ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i cili në nenin 34, pika 2, parashikonte se : “Fillimi i procedimit disiplinor mund të bëhet jo më vonë se 1 vit nga data e konstatimit të shkeljes nga organi që ka të drejtën për fillimin e këtij procedimi, por jo më vonë se 5 vjet nga data e kryerjes së shkeljes”

42. Nisur nga sa më sipër, sjellim në vëmendje se instituti i parashkrimit të procedimit disiplinor të magjistratit ka qenë parashikuar në nenin 34, pika 2, të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohej

se fillimi i procedimit disiplinor mund të bëhet *jo më vonë se 5 vjet nga data e kryerjes së shkeljes*.<sup>[3]</sup> I njëjti parim që lidhet me institutin e parashkrimit të procedimit disiplinor të gjyqtarit për efekt të sigurisë juridike, parashikohet edhe në ligjin nr. 96/2016. Referuar nenit 117 të këtij ligji, “shkeljet disiplinore parashkruhen brenda pesë vjetëve dhe se afati i parashkrimit fillon nga momenti kur shkelja e pretenduar është kryer”. Gjithashtu, kjo dispozitë parashikon edhe rastin se kur Inspektori i Lartë i Drejtësisë merr të dhëna pas 5 vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar, ai nuk fillon hetimin për shkak të parashkrimit.<sup>[4]</sup>

43. Në ligjin nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, nuk ka dispozitë analoge si ajo e nenit 126 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, i cili në pikën 5 parashikon se: “*Pezullimi i hetimeve ndërpret afatet e parashkrimit të parashikuara nga neni 117 i këtij ligji, për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë*”

44. Për sa më sipër, rezulton se shkeljet e pretenduara për të cilat ka nisur procedimi disiplinor ndaj magjistratit {...}, dhe të cilat kanë të bëjnë me vendime gjyqësore të vitit 2009 dhe 2012, janë parashkruar. Instituti i parashkrimit shuan të drejtën e organit disiplinor të hetojë dhe të japë vendim për masë disiplinore ndaj magjistratit për shkak të kalimit të një kohe të gjatë nga koha e kryerjes së shkeljes disiplinore, afat i cili llogaritet nga momenti i kryerjes së shkeljes së pretenduar. Respektimi i afatit të parashikuar për kryerjen e procedimeve disiplinore është në funksion të garantimit të parimit të sigurisë juridike.

45. Në rastin konkret, referuar të gjitha fakteve të konstatuara, analizës ligjore të tyre si dhe kriterëve të analizuara në këtë vendim, Këshilli i Lartë Gjyqësor arrin në përfundimin se procedimi disiplinor i filluar ndaj magjistratit {...}, duhet të mbyllet për shkak të parashkrimit të shkeljeve disiplinore të pretenduara.

46. Së fundi, në lidhje me të drejtën e ankimit, Këshilli verën se neni 147 i Ligjit për Statusin përcakton të drejtën e ankimit ndaj vendimeve disiplinore. Sipas këtij neni, magjistrati dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë kanë të drejtë të ankimojnë vendimin për caktimin e masës disiplinore në gjykatën kompetente. Një dispozitë e veçantë për ankimet është vendosur dhe në Ligjin nr.115/2016, “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, i ndryshuar, konkretisht në nenin 100 të tij, në të cilin parashikohet se: “*Ndaj aktit administrativ individual të Këshillit mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit, përveçse kur parashikohet ndryshe në ligj. Aktet administrative*

---

<sup>3</sup> Neni 34/2 i ligj nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” ne lidhje me in disiplinor i gjyqtarit, parashikon “2. *Fillimi i procedimit disiplinor mund të bëhet jo më vonë se 1 vit nga data e konstatimit të shkeljes nga organi që ka të drejtën për fillimin e këtij i, por jo më vonë se 5 vjet nga data e kryerjes së shkeljes*”.

<sup>4</sup>Në nenin 117/1, paragrafi i dytë i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, parashikohet: “*Nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë merr të dhëna, sipas nenit 124, të këtij ligji, pas 5 vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar, ai nuk fillon hetimin për shkak të parashkrimit. Afati i parashkrimit fillon nga momenti kur shkelja e pretenduar është kryer.*

*individuale që vendosin masa disiplinore mbi gjyqtarët ankimohen në Gjykatën Kushtetuese....”*

### **PËR KËTO ARSYE:**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 147,147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 117, 139 dhe 172 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 86, shkronja “e”, nenet 97, 98 dhe 100 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 104 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë,

### **V E N D O S I:**

1. Mbyllet e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për shkak të parashkrimit të shkeljeve disiplinore të pretenduara, për të cilat ka nisur ky procedim.
2. Një kopje e vendimit të arsyetuar t’i njoftohet z. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

### **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**